



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 591/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore gjatë ditës së zgjedhjeve, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar anesa e Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 200 (dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Me datën 04. 11. 2013 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga BIRN, në të cilën theksohet se me datën 03.11.2013 ministri Enver Hoxhaj nga subjekti politik PDK ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë fushatë përmes postimit të një statusi dhe publikimin e një fotografie në Prizren , andaj me këtë rast sipas parashtruesit të ankesës ky veprim bie ndesh me dispozitat e LZP-së

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 05.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 06.11.2013, ora 10:00. PZAP-i, nuk pranoi përgjigjen në ankesë nga PDK-ja,

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesë është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të bashkangjitura shkresës së lëndës shihet qartë se si anëtari i PDK Enver Hoxhaj me datën 03 nëntor gjatë ditës së zgjedhjeve duke bërë fushatë zgjedhore dhe duke bërë postim të fotografive të tija gjatë fushatës zgjedhore, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me nenin 36.1 pika b) të LZP-së të cilat përcaktojnë që njëzetekatër (24) orë para hapjes së qendrave të voimit për hedhjen e votes e deri në

mbylljen e tyre, subjekteve politike, mështetesve ose kandidateve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfardo mënyre.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njofuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Andaj duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës PZAP-i vlerëson se subjekti politik PDK në këtë rast ka thyer kodin e mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, shkelje për të cilën parashihet shqiptimi i dënimit me gjobë. Andaj mbi ktë bazë si dhe në kuptim të nenit 36.1 pika b) dhe nenit 118.1 lidhur me nenit 120 paragrafi 1 pika (c) të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 591/2013 më datën 07.11.2013.



#### **Këshillë Juridike:**

PZAP nuk do t'i pranojë kërkasat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.